

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rifillojnë kërkimet arkeologjike në fshatin Gajtan
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/fillojne-kerkimet-arkeologjike-ne-fshatin-gajtan-i588319
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 11:50:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 11:46:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4fbdcccd661d480ff0ce3ddee42435bed1a0d4a808e1f5a1e640979c9750ba3db
TEKSTI	9d6ba8ed8871698af76056ca67dc5a33b8fc936a7d9ab316a40bb7a72bf1223e
PAMJA	99ade8efe7a0a462433bff9024cd7dcd9c08ca4325e2d70ad299c8b7a538ba2d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c18abb10ef9cf5465e5c39e655ade749e6539664d702385a71f5bb71e9925569
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3f529bf32420afe1b21bc6d3b8138bcb5df45885bcaf02ba5967dcac0a879fe4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c18abb10ef9cf5465e5c39e655ade749e6539664d702385a71f5bb71e9925569>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by  [Kontakt](#)



 [English](#)



le [Keshilli Bashkiak tton Veliajn ne mbledhje - Kerkese SPAK-ut dhe Burgjeve per pjesemarrjenRifillojne kerkimet arkeologjike ne fshatin GajtanAmbasada Amerikane ne fundit](#)

Rifillojnë kërkimet arkeologjike në fshatin Gajtan



25 Shtator 2026, 13:46Kulturë TEMA



Në fshatin Gajtan, pranë shpellës me të njëjtin emër, rifilluan për të dytin vit radhazi kërkimet arkeologjike në kuadër të projektit “Gajtan, kërkime arkeologjike paleolitike në Shqipëri” (GRAAL).

Projekti drejtohet nga arkeologu Rudens Ruka dhe është rezultat i një bashkëpunimi ndërinstitutional ndërmjet Institutit të Arkeologjisë dhe disa institucioneve kërkimore-shkencore franceze.

Fshati Gajtan ndodhet në lindje/juglindje të qytetit të Shkodrës, në varësi të pikës së referimit dhe rrugës së përdorur. Ndërsa fortifikimi ilir i quajtur Qyteza e Gajtani është një vendbanim i epokës së hekurit, i vendosur mbi një kodër në verilindje të fshatit Gajtan, rreth 5 km në lindje të Shkodrës. Fortifikimi përbëhet nga mure rrethuese prej guri dhe është shpallur Monument Kulture i Kategorisë I.

Drejtorja Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër bëri të ditur se, vëmendja është përqendruar në sektorin qendror të shpellës, në pjesën e sipërme dhe të shembur të saj, pikërisht në zonën ku u ndërprejnë gërmimet e viteve 1980, të kryera nga Anton Fistani. Metodologjia e punës konsiston në heqjen e depozitimeve shtresë pas shtrese, me synim rikuperimin e mikrofaunës dhe të treguesve të ndryshëm mjedisorë.

Përmes ndërhyrjeve në terren dhe përfshirjes në procesin kërkimor, projekti synon të nxisë interesin dhe vëmendjen ndaj arkeologjisë paleolitike në Shqipëri.

Kjo fushatë pritet të kontribuojë në krijimin e një panorame më të plotë mbi potencialin paleolitik të zonës së Gajtanit, duke ndihmuar në identifikimin dhe përzgjedhjen e zonave prioritare për kërkimet arkeologjike të vitit 2027. A.K./TemA

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

DPA paraqiti një ekspozitë me dokumente mbi historikun e marrëdhënieve Shqipëri-Kinë.

12:51 Kulturë

"Diskriminon produksionet vendase"/ Shoqata e Kineastëve kundërshton projektligjin për kinematografinë

11:38 Kulturë

Rreth darvinizmit leksikor

10:34 Kulturë

Zbulimet e reja arkeologjike në Tepelenë, Rama: Po punohet për dokumentimin, pastrimin dhe konservimin e këtyre zbulimeve

09:42 Kulturë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.